

BASHKIA POGRADEC & PARTNERITETI PUBLIK-PRIVAT

Mbështesim Biznesin
Konsolidojmë **Ekonominë Lokale**
Sigurojmë **Mirëqënie**



SIPËRMARRJA PRIVATE & PUSHTETI LOKAL

Hapësira sipërmarrëse kërkon vëmendjen e duhur të Pushtetit Lokal dhe mbështetjen maksimale të tij, sidomos në periudha të tilla krizash kombëtare, rajonale dhe globale.

Bashkia Pogradec do të ndër marrë iniciativat që vijojnë, për sipërmarrjen private:

- ⇒ **Ulje të taksave** dhe tarifave vendore në konsensus me biznesin;
- ⇒ Ndihmë biznesit mes një **infrastruktura urbane bashkëkohore**, krejtësisht të transformuar, krahasuar me këtë ekzistuese (rrugë, trotuare, ndriçim, gjelbërim, pastrim, parking etj.);
- ⇒ **Gjetjen e burimeve financiare** (fondeve) në mbështetje direkte të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- ⇒ **Trajnim periodik i personelit**, duke i dhënë mundësinë sipërmarrjes private të ketë një personel të kualifikuar dhe më të aftë;
- ⇒ **Reklamim dhe promocionin** për të gjitha sipërmarrjet në Rrjetin Kombëtar Elektronik të Bizneseve;
- ⇒ **Kooperimin me donatorë dhe partnerë të huaj** për zhvillimin dhe konsolidimin e sipërmarrjes private;
- ⇒ Suport i specializuar, **konsulencë**, për konsolidimin e bizneseve që operojnë kryesisht në zonat urbane;
- ⇒ **Suport për sipërmarrësit e rinj** që i drejtohen bankave të nivelit të dytë për 'kredi biznesi', duke iu afruar atyre 'garancinë' pas shtyrtimit të Plan-Biznesit të tyre;
- ⇒ **Hartim Plan-Biznesesh** për të gjithë të rinjtë që dëshirojnë të krijojnë një sipërmarrje private;
- ⇒ **Investime për Pazarin / Tregun e Ushqimeve** dhe Artikujve të tjerë të konsumit në qytetin e Pogradecit, duke përmirësuar kushtet e tregtimit;

Mes mbështetjes së biznesit me fonde dhe mes suportit teknik, do të nxisim punësimin, duke e parë këtë si prioritet për shmangien e varfërisë dhe përmirësimin e nivelit të jetesës.

**FONDET QË BASHKIA DO TË VJELË NGA BIZNESI NË NJË VIT KALENDARIK,
DO TË KENË DESTINACION TË TYRE INVESTIMI, SËRISH HAPËSIRËN SIPËRMARRËSE DHE KONSOLIDIMIN
E EKONOMIVE LOKALE, SI E VETMJA RRUGË DREJT MIRËQËNIES, STABILITETIT SOCIAL-EKONOMIK
DHE ZHVILLIMIT TË INTEGRUIAR.**

BASHKË PËR POGRADECIN

Eduart Kapri